

LIGJ
Nr. 129/2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 81/2020, “PËR TË DREJTAT DHE
TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 26 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 4 togfjalëshi “legjislacioni për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore në zbatim të tij” zëvendësohet me togfjalëshin “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë dhe rregulloren e brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve”.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve dhe punonjësve mbështetës të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale rregullohen sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë. Kriteret dhe procedurat për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve mbështetës përcaktohen në rregulloren e brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe rregulloret e brendshme të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Niveli i pagave të nëpunësve dhe punonjësve mbështetës të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me ligjin nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar.

Neni 2

Dispozitë kalimtare

Nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, marrëdhëniet e punës së të cilëve aktualisht rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil, vijnë në marrëdhënie të tyre të punës sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 19.12.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 429, datë 26.12.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**